

Deklarata e bërë më 9 maj 1950 nga Z. Robert Schuman, Ministër i Punëve të Jashtme të Republikës Franceze

Zotërinj,

Nuk ka më vend për fjalë të kota, por duhet një përpjekje, një përpjekje e guximshme, një përpjekje konstruktive. Franca po vepron dhe pasojat e përpjekjes së saj mund të jenë pa fund.

Ne shpresojmë që të jenë të tilla.

Ajo po përpiqet në radhë të parë për paqen. Por që paqja të ketë mundësi të realizohet, në radhë të parë, duhet që të ketë një Europë. Pesë vjet, afërsisht ditë më ditë, pas kapitullimit pa kushte të Gjermanisë, Franca ndërmer aktin e parë vendimtar për ndërtimin europian duke përfshirë këtu edhe Gjermaninë. Situata europiane duhet ndryshuar rrënjësisht. Ky ndryshim duhet të bëjë të mundur veprime të tjera të përbashkëta të pamundura deri më sot. Nga gjithë kjo do të lindë Europa, një Europë e bashkuar fort dhe e ndërtuar në mënyrë solide. Një Europës ku niveli i jetesës do të ngrihet falë grupimit të prodhimeve dhe hapjes së tregjeve, të cilat do të sjellin uljen e çmimeve.

Një Europë ku Ruhri, Sara dhe rezervat franceze do të punojnë së bashku dhe do të bëjnë që nga puna e tyre paqësore, e ndjekur nga vëzhguesit e Kombeve të Bashkuara, të përfitojnë të gjithë europianët, pa dallim nëse janë nga lindja ose nga perëndimi, dhe të gjitha territoret, sidomos Afrika e cila pret nga Kontinenti i Vjetër zhvillimin dhe prosperitetin e saj.

Ju paraqes tani këtë vendim, së bashku me vlerësimet që e kanë frymëzuar.

“Paqja botërore nuk do të mund të ruhet pa përpjekje krijuese në lartësinë e rreziqeve që e kanosin.

Kontributi që një Europë e organizuar dhe plot jetë mund t'i sjellë qytetërimit është i domosdoshëm për ruajtjen e marrëdhënieve paqësore. Duke qenë, qysh prej më shumë se njëzet vjetësh, në krye të përpjekjeve për një Europë të bashkuar, Franca ka pasur gjithmonë si objektiv thelbësor t'i shërbejë paqes. Megjithatë Europa nuk arriti të bëhej, ne kemi pasur luftë.

Europa nuk mund të bëhet me një të goditur, as edhe në një ngrehinë të vetme: ajo do të bëhet me anë realizimesh konkrete duke krijuar më së pari një solidaritet real.

Bashkimi i të gjitha kombeve europiane kërkon që një armiqësi shekullore mes Francës dhe Gjermanisë të marrë fund: angazhimet për veprime duhet të merren përsipër në radhë të parë nga Franca dhe Gjermania.

Për këtë qëllim, qeveria franceze propozon që të ndërmerret menjëherë një veprim, në një kuadër të kufizuar, por gjithsesi vendimtare:

Qeveria franceze propozon që të vendoset tërësia e prodhimit franko-gjerman të qymyrit dhe çelikut, nën një Autoritet të Lartë të përbashkët, në një organizatë të hapur për pjesëmarrjen edhe të vendeve të tjera të Europës.

Bashkimi i prodhimit të qymyrit dhe çelikut do të sigurojë menjëherë hedhjen e themeleve të përbashkëta, të zhvillimit ekonomik, si etapë e parë e Federatës Europiane, dhe do të ndryshojë fatin e rajoneve që për shumë kohë i ishin kushtuar fabrikimit të armëve të luftës, viktimat më të shpeshta të të cilave kanë qenë vetë këto rajone.

Solidariteti i prodhimit, i ndërtuar në këtë mënyrë, do të nxirrte në pah se çdo luftë ndërmjet Francës dhe Gjermanisë do të bëhej jo vetëm e pamendueshme, por edhe materialisht e pamundur. Krijimi i kësaj njësie të fuqishme të prodhimit, e hapur për të gjitha vendeve që dëshirojnë të marrin pjesë në të, duke arritur që t'u ofronte, në të njëjtat kushte, të gjitha vendeve pjesëmarrëse elementët thelbësorë të prodhimit industrial, do të hidhte themelet reale të bashkimit të tyre ekonomik.

Ky prodhim do t'i ofrohet njerëzimit pa dallim dhe pa përjashtim, me qëllim që të kontribuojë në ngritjen e nivelit të jetesës dhe në përparimin e paqes...

...Kështu do të realizohet thjesht dhe shpejt shkrimi dhe interesave të domosdoshme për krijimin e një komuniteti ekonomik dhe do të mbillej fara e një komuniteti më të gjerë dhe më të thellë ndërmjet vendeve që prej kohësh kanë qenë të ndarë nga njëri tjetri me kufij gjaku.

Me anë të bashkimit të prodhimeve bazë dhe krijimit të një Autoriteti të ri të Lartë, vendimet e të cilit do të jenë të detyrueshme për Francën, Gjermaninë dhe vendet që do të aderojnë, ky propozim do të realizojë kolonat e para konkrete të një Federate europiane të domosdoshme për ruajtjen e paqes.

Për të realizuar objektivat e përmendur më lart, qeveria franceze është e gatshme që të nisë bisedimet mbi bazat e mëposhtme:

Misioni që i është ngarkuar Autoritetit të Lartë të përbashkët do të jetë sigurimi, në një kohë sa më të shkurtër: i modernizimit të prodhimit dhe i përmirësimit të cilësisë së tij; i furnizimit, në kushte të njëjta, me qymyr dhe çelik, të tregut francez dhe atij gjerman, gjithashtu edhe të tregjeve të vendeve aderuese; i zhvillimit të eksportit të përbashkët drejt vendeve të tjera; i barazisë progresive të kushteve të jetesës dhe të fuqisë punëtore të këtyre industrive.

Për arritjen e këtyre objektivave, duke marrë parasysh kushtet shumë të ndryshme në të cilat gjenden aktualisht prodhimet në vendet aderuese, disa rregulla me karakter kalimtar duhet të vihen në jetë, përfshirë këtu zbatimin e një plani prodhimi dhe investimesh, vendosjen e mekanizmave të ekuilibrit të çmimeve, krijimin e një fondi strukturimesh që do të lehtësonte racionalizimin e prodhimit. Qarkullimi i qymyrit dhe i çelikut mes vendeve aderuese do të jetë menjëherë i përjashtuar nga çdo detyrim doganor dhe nuk do të mund t'u nënshtrohet tarifave të ndryshme të transportit. Në mënyrë progresive, do të vihen në lëvizje kushtet që do të sigurojnë një shpërndarje më racionale të prodhimit në nivelin më të lartë të prodhimitarisë.

Në kundërshtim me një kartel ndërkombëtar, i cili konsiston në ndarjen dhe shfrytëzimin e tregjeve kombëtare me anë të praktikave kufizuese dhe mbajtjes së fitimeve të larta, organizata e projektuar do të sigurojë shkrirjen e tregjeve dhe shtrirjen e prodhimit.

Parimet dhe angazhimet thelbësore të përcaktuara më lart do të jenë objekt i një traktati të nënshkruar nga vendet anëtare dhe që do t'i nënshtrohet në vijim ratifikimit nga ana e Parlamenteve të tyre. Negociatat e domosdoshme për të përcaktuar masat e zbatimit do të realizohen me pjesëmarrjen e një arbitri të caktuar me marrëveshje të përbashkët; ky i fundit do të kërkojë respektimin nga marrëveshja të parimeve dhe, në rast të një kundërshtie të pashmangshme, do të caktojë zgjidhjen përfundimtare. Autoriteti i Lartë i përbashkët, i ngarkuar me funksionimin e të gjithë sistemit, do të përbëhet nga personalitete të pavarura, të caktuara në bazë të barazisë nga qeveritë; qeveritë, me marrëveshje të përbashkët, zgjedhin një president; vendimet e tij do të jenë të ekzekutueshme në Francë, në Gjermani dhe në vendet e tjera aderuese. Dispozita të përshtatshme do të garantojnë mjetet e ankimeve të nevojshme kundër vendimeve të Autoritetit të Lartë. Një përfaqësues i Kombeve të Bashkuara pranë këtij Autoriteti do të ngarkohet që të bëjë dy herë në vit një raport publik pranë O.K.B.-së duke paraqitur funksionimin e organizatës së re, sidomos përsa i përket mbrojtjes së qëllimeve paqësore.¹

Krijimi i Autoritetit të Lartë nuk cenon aspak regjimin e pronësisë së ndërmarrjeve. Në Ushtrimin e misionit të saj, Autoriteti i Lartë i përbashkët do të mbajë parasysh kompetencat që i janë dhënë Autoritetit Ndërkombëtar të Ruhrit dhe të gjitha llojet e detyrimeve që i janë vënë Gjermanisë, për aq kohë sa këto do të vazhdojnë të ekzistojnë”.

¹ Marrë nga "Droit International et Histoire Diplomatique" (tome 2) - Colliard et Manin (shën. i përkthimit).